

Nr. xxxxxx Sot me Datë: 27.02.2026 sipas Aplikimit me nr. xxxxxx Palët e mëposhtme nënshkruan këtë Kontratë për Linjë Kredie si vijon:

PJESA I. INFORMACION MBI PALËT DHE KREDINË

KREDIDHËNËS

Emri i Shoqërisë: ECFA Sh.a
Numri i Regjistrimit: L71610009A
Selia: Rruga "Muhamet Gjollështa", Ndertesa Tirana Ring Center, Nr. 8, Kati i 9-te, Tirane, Albania
Vendi i ofrimit: Njesia Bashkiake Nr 7, Rruga "Muhamet Gjollështa", Zogu i Zi, Tirane
Adresa e-mail: info@kredo.al
Telefon: +355 44 500 600

KREDIMARRËS

xxxx xxxx, Person Fizik regjistruar më datë xx.xx.xxxx, prane Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjektit NIPT xxxxxxxx, me seli në Tirane, me të drejta të plota, si dhe Garantues i kredisë sipas ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” neni 2, Tregtari, përfaqësuar nga
Emër, mbiemër: xxxx xxxx
Emri i babait: xxxx
Numri personal i identifikimit: xxxxxxxx
Letërnjoftimi/Pasaporta: ID Card
Adresa: 1001, Tirane,
Tirane Adresa e-mail: Telefon: +(355) 68xxxxxxx
Mënyra e Disbursimit: Kesh

PJESA II. KUSHTET E KREDISË

1. Afati i Kredisë

24 muaj
Në çdo rast kur kredia është përfituar me Ofertë, lexoni kushtet e përdorimit dhe anulimit të Ofertës në <https://www.kredo.al/faqet/oferta>.

2. Limitet

2.1. Limiti i Linjës së Kredisë: 600,000.00 ALL sipas datës së aplikimit
2.2. Shuma e Kredisë së lëvruar: 200,000.00 ALL

3. Norma nominale e interesit: 18 %

4. NEI, Norma efektive e interesit: 40.61 % (detajet e përlllogaritjes sipas aneks 1)

5. Tarifat

Komisioni i angazhimit të kredisë: 20.00 %, vlerë totale prej 40000.00 ALL
☒ Paguhet me kështet ☐ Paguhet në momentin e lëvrimit
Komisioni i lëvrimit të kredisë me para në dorë: 8.00 %, vlerë totale 16000.00 ALL
☒ Paguhet me kështet ☐ Paguhet në momentin e lëvrimit
Shuma totale për t'u paguar nga Kredimarrësi: 295,450.00 ALL.
Në rast se klienti do të bëjë shlyerje të parakohshme të kredisë do të paguajë shumën totale të lëvrimit të kredisë me para në dorë. Komisioni për mbyllje parakohe përlllogaritët mbi kryegjënë e mbetur në momentin e mbylljes parakohe, sic percaktohet ne piken 9.4 te kesaj kontrate.

6. Grafiku i Pagesës

Data e Pagesës	Pagesa e Principalit, ALL:	Pagesa e Interesit, ALL:	Komisioni i Angazhimit, ALL:	Komisioni për Lëvrim Kesh, ALL:	Pagesa totale mujore, ALL
27.03.2026	7,220.00	2,750.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.04.2026	7,030.00	2,940.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.05.2026	7,230.00	2,740.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.06.2026	7,250.00	2,720.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.07.2026	7,440.00	2,530.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.08.2026	7,470.00	2,500.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.09.2026	7,590.00	2,380.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.10.2026	7,780.00	2,190.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.11.2026	7,820.00	2,150.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.12.2026	8,010.00	1,980.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.01.2027	8,060.00	1,910.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.02.2027	8,190.00	1,800.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.03.2027	8,470.00	1,500.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.04.2027	8,440.00	1,550.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.05.2027	8,620.00	1,350.00	1,670.00	670.00	12,310.00

27.06.2027	8,700.00	1,290.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.07.2027	8,870.00	1,100.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.08.2027	8,970.00	1,020.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.09.2027	9,110.00	860.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.10.2027	9,270.00	720.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.11.2027	9,390.00	580.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.12.2027	9,550.00	440.00	1,660.00	660.00	12,310.00
27.01.2028	9,680.00	290.00	1,670.00	670.00	12,310.00
27.02.2028	9,840.00	160.00	1,660.00	660.00	12,320.00

Vlerat rrumbullakosen në 10-she të plota, diferencat nëse ka pasqyrohen tek interesi.

Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate, Kredimarrësi deklaron posaçërisht se ai/ajo është plotësisht në dijeni dhe pranon kushtet e këtij Aplikimi, Grafikun e Pagesave dhe Komisionet e Kushteve të Llogarise Online dhe të Politikës së Privatesisë të Kredidhënesit, siç janë ato në fuqi në Datën e Nënshkrimit. Çdo ndryshim i këtyre dokumenteve do t'i njoftohet Kredimarrësit për të dhënë pëlqimin në zbatim të Kontratës së linjës së Kredisë.

Për Kredidhënesin:

Kredimarrësi:

[Emër, Mbiemër, Firmë]
Përfaqësues i Autorizuar

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

1. Përcaktimet 1.1 Termat e përcaktuara në vijim, si dhe termat e përcaktuara diku tjetër në këtë Kontratë, do të përdoren në këtë Kontratë sipas kuptimit përkatës: 1.1.1 Kredimarrësi: do të thotë biznesi i identifikuar si i tillë në hyrjen e kësaj Kontrate dhe përfaqësuar nga individit respektiv me të drejta të plota, si dhe Garantues i kredisë sipas ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" neni 2, Tregtari. 1.1.2 Llogaria Bankare e Kredimarrësit: do të thotë llogaria bankare e Kredimarrësit shënuar më sipër në hyrje të kësaj Kontrate, siç mund të ndryshohet nga Kredimarrësi nëpërmjet një Njoftimi sipas Nenit 12 të kësaj Kontrate, apo çdo llogari tjetër bankare nga e cila Kredimarrësi ka kryer pagesa për Kredidhënësin. 1.1.3 Kontaktet e Kredimarrësit: adresa e e-mailit dhe/ose numri i celularit/telefonit të Kredimarrësit, shënuar më sipër në hyrje të kësaj Kontrate, siç mund të ndryshohet nga Kredimarrësi nëpërmjet një Njoftimi sipas Nenit 12 të kësaj Kontrate, tek të cilat Kredimarrësi pranon të kontaktohet dhe të marrë Njoftime dhe komunikime nga Kredidhënësi. 1.1.4 Degët: janë ambientet e Kredidhënësit dhe/ose të partnerëve të autorizuar prej tij, nëpërmjet të cilave Kredidhënësi ushtron aktivitetin; një listë e plotë e Degëve gjendet në Faqen e Internetit të Kredidhënësit <http://www.kredo.al/deget>. 1.1.5 Ditë Pune: çdo ditë e javës përveç ditës së dielë dhe ditëve të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. 1.1.6 Tarifat: janë tarifatat, komisionet dhe kostot e tjera të shënuara në Tabelën e Interesit dhe Tarifave të Kredidhënësit (përcaktuar si vijon), që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënësit në lidhje me këtë Kontratë. 1.1.7 Kontratë: është kjo Kontratë për Linjë Kredie, lidhur mes Kredimarrësit dhe Kredidhënësit. 1.1.8 Mosmarrëveshjet: janë mosmarrëveshjet e përcaktuara sipas Nenit 14 të kësaj Kontrate. 1.1.9 Kryegjë (Principal): shumata monetare kryesore e lëvruar sipas njëmarrëveshjeje kredie, në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". 1.1.10 Lëvrim: është çdo shumë që Kredidhënësi i disburson Kredimarrësit sipas kësaj Kontrate, mbi bazën e një Aplikimi për Disbursim të paraqitur nga Kredimarrësi. 1.1.11 Afati: është afati i kësaj Kontrate, përcaktuar sipas Nenit 4 të kësaj Kontrate, në vijim. 1.1.12 Rast Mospërmbushjeje: janë rrethanat e përcaktuara sipas Nenit 13 të kësaj Kontrate. 1.1.13 Interesi: Norma nominale e interesit për shlyerjen e kredisë paraqitet si % vjetore e pandryshueshme në vit, llogaritur mbi principalin e mbetur. 1.1.14 Norma e Interesit: norma në përqindje mbi Shumën e Kredisë së mbetur, që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënësit si Interes; Norma e Interesit përcaktohet dhe llogaritet sipas kushteve dhe afateve të Tabelës së Interesit dhe të Tarifave të Kredidhënësit (përcaktuar si vijon), siç është në fuqi në momentin e zbatimit. 1.1.15 Norma Efektive e Interesit: Në momentin e nënshkrimit të Kontratës Norma Efektive e Interesit (NEI) është në %. Norma Efektive e Interesit është totali i kostos së kredisë për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë. 1.1.16 Tarifë mbi Vonesat: është shumata e tarifës së zbatuar ndaj Kredimarrësit në rast të pagesës së vonuar të Shumave të Pashlyera sipas kësaj Kontrate; Masa e Tarifës dhe mënyra e llogaritjes së saj përcaktohen sipas kushteve dhe afateve të Tabelës së Interesit dhe të Komisioneve të Kredidhënësit (përcaktuar si vijon), siç është në fuqi në momentin e zbatimit. . 1.1.17 Kredidhënësi: është shoqëria ECFA Sh.a - NUIS L71610009A. 1.1.18 Llogaria Bankare e Kredidhënësit: çdo llogari bankare e publikuar nga Kredidhënësi në Faqen e Internetit të Kredidhënësit (përcaktuar si vijon), si dhe pranë Degëve. 1.1.19 Shuma e Kredisë: është shumata totale e të gjitha Disbursimeve të kryera nga Kredidhënësi, që në çdo moment kohor rezulton e pakthyer nga ana e Kredimarrësit. 1.1.20 Aplikim për Ndryshimin e Kushteve: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënësi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për ndryshimin e kushteve origjinale të një shume të Disbursuar. 1.1.21 Aplikim për Disbursim: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënësi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për disbursimin e një Shume Kredie, deri në vlerën e Limitit. 1.1.22 Komisioni i angazhimit, është komisioni për angazhimin e lëvrimit të kredisë, për llogaritjet mbi vlerën e kredisë së lëvruar dhe është i detyrueshëm për t'u paguar i plotë pavarësisht afatit të mbajtjes së kredisë. 1.1.23 Komisioni për lëvrimin e kredisë me para në dorë, është komisioni që paguhet në rastet kur Kredimarrësi zgjedh që kredia e tij të lëvrohet me para në dorë dhe jo me transfertë bankare. Për llogaritjet mbi vlerën e kredisë së lëvruar dhe është i detyrueshëm për t'u paguar i plotë pavarësisht afatit të mbajtjes së kredisë. 1.1.24 Komisioni për shërbimin e pagesave: Kredimarrësi mund të zgjedhë të kryejë pagesat që lidhen me kredinë në një nga degët e ECFA Sh.a ose në bankë apo institucione të tjera të pagesave me të cilat ECFA Sh.a ka një marrëveshje bashkëpunimi. Në rast se kryerja e pagesave do të bëhet në degët e ECFA Sh.a, atëherë do të aplikohet komisioni për shërbimin e pagesave sipas tabelës së Interesit dhe Tarifave në fuqi. 1.1.25 Limiti: do të thotë vlera totale e miratuar nga Kredidhënësi, deri tek e cila Kredimarrësi lejohet të tërheqë, në çdo moment kohor, totali i shumave të lëvuara. Limiti nuk përfshin ndonjë nga Tarifatat e zbatueshme. 1.1.26 Aplikim për Limit: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënësi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për rritjen e Limitit të miratuar më parë nga Kredidhënësi. 1.1.27 Njoftim është çdo njoftim apo komunikim mes Kredidhënësit dhe Kredimarrësit në lidhje me këtë Kontratë, sipas përcaktimeve të Nenit 12 të kësaj Kontrate. 1.1.28 Llogaria Online: do të thotë llogaria e klientit, përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Kontrate. 1.1.29 Kushtet e Llogarisë Online: janë kushtet dhe afatet e miratuara nga Kredidhënësi, siç janë në fuqi në momentin e zbatimit, të cilat rregullojnë mbajtjen dhe operimin e Llogarisë Online; Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit (<https://www.kredo.al/faqet/kushtet-dhe-afatet>) një kopje të Kushteve të Llogarisë Online, në fuqi në çdo kohë, dhe çdo ndryshim i Kushteve të Llogarisë Online do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Kontrate. 1.1.30 Tabela e Interesit dhe të Komisioneve të Kredidhënësit: është tabela e publikuar nga Kredidhënësi në faqen zyrtare <https://www.kredo.al/faqet/tarifat> ku detajohen kostot e kredisë, që janë në fuqi. 1.1.31 Shumat e Pashlyera: shumat e përgjithshme që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënësit sipas kësaj Kontrate, përbërë nga Shumat e Kredisë, Interesi dhe Tarifatat e papaguara në çdo moment kohor. 1.1.32 Pala ose Palët: janë Kredidhënësi dhe/ose Kredimarrësi, bashkërisht apo veçmas, sipas rastit. 1.1.33 Grafiku i Pagesave: tabela me shumat dhe afatet e rikthimit apo shlyerjes së çdo Shume Kredie, Interesi apo komisioni pranuar nga Kredimarrësi në bazë të një Aplikimi Disbursimi, siç mund të jetë ndryshe Kredia sipas një a më shumë Aplikimeve për Ndryshim të Kushteve, të miratuar nga Kredidhënësi. 1.1.34 Data e Pagesave: është data në të cilën Kredimarrësi detyrohet të shlyejë një Shumë Kredie, apo të paguajë Interesin dhe/ose Tarifatat, sipas Grafikut të Pagesave, apo afateve të tjera të parashikuara sipas kësaj Kontrate. 1.1.35 Politika e Privatësisë: është dokumenti i miratuar nga Kredidhënësi, siç është në fuqi në momentin e zbatimit, që rregullon kushtet dhe afatet e mbledhjes dhe trajtimit të të dhënave personale të Kredimarrësit; Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit (<https://www.kredo.al/faqet/politika-e-privatesise>) një kopje të Politikës së Privatësisë, në fuqi në çdo kohë dhe çdo ndryshim i Politikës së Privatësisë do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Kontrate. 1.1.36 Njoftimi i Korrigjimit: është njoftimi i përcaktuar sipas Nenit 13 të kësaj Kontrate.

<https://www.kredo.al/>

1.1.37 Tabela e Interesit dhe Tarifave: është dokumenti i miratuar nga Kredidhënësi, siç është në fuqi në momentin e zbatimit, që përmban Normën e Interesit, Kamatëvonesën dhe Tarifat, si dhe mënyrat përkatëse të llogaritjes së tyre. Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit një kopje të Tabelës së Interesit dhe Tarifave, në fuqi në çdo kohë dhe çdo ndryshim i Tabelës së Interesit dhe Tarifave do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Kontrate. 1.1.38 Data e Nënshkrimit: data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Kredimarrësi dhe Kredidhënësi, siç është shënuar më sipër. 1.1.39 Njoftimi i Zgjidhjes: është njoftimi i përcaktuar sipas Nenit 13 të kësaj Kontrate. 1.1.40 Faqja e Internetit: është faqja në internet e Kredidhënësit, www.kredo.al. 2. Interpretimi

2.1 Kjo Kontratë, përveçse kur nga konteksti i dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, do të interpretohet sipas parashikimeve vijuese:

2.1.1 Kur në këtë Kontratë i bëhet reference ndonjë neni, seksioni, paragrafi, apo dokumenti tjetër, atëherë, përveçse kur nga konteksti rezulton ndryshe, kjo referencë do të jetë tek neni, seksioni apo paragrafi përkatës i kësaj Kontrate, apo tek dokumenti tjetër i cituar në këtë Kontratë, siç ky dokument është në fuqi në momentin e zbatimit.

2.1.2 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën-paragrafët, janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Kontrate dhe nuk do të çenojnë në asnjë mënyrë, kuptimin apo interpretimin e përmbajtjes së dispozitave përkatëse.

2.1.3 Sa herë që në këtë Kontratë përdoren fjalët “duke përfshirë”, “përfshin”, “në veçanti”, “për shembull” e të tilla të ngjashme, këto fjalë do të kuptohen të ndjekura nga fjalët “pa u kufizuar vetëm në to”.

2.1.4 Fjalët “këtu”, “në këtë”, “më poshtë” apo fjalë të ngjashme të përdorura në këtë Kontratë, përveçse kur nga konteksti rezulton ndryshe, do të kuptohen si referencë në këtë Kontratë në tërësi, dhe jo në ndonjë nen, seksion apo paragraf të veçantë të kësaj Kontrate.

2.1.5 Kur afati është caktuar me “ditë”, këto do të jenë ditë kalendarike, përveçse kur parashikohen shprehimisht si Ditë Pune. Një afat prej një ose më shumë ditësh kalendarike ose Ditësh Pune do të nisë të llogaritet duke nisur nga dita kalendarike ose Dita e Punës e mëpasshme.

2.1.6 Kur afati është caktuar me “javë”, “muaj” ose “vite”, atëherë afati do të llogaritet nga data në datë (“data korresponduese”). Kur afati është caktuar në “muaj”, nëse muaji i fundit kalendari i periudhës përkatëse nuk ka një datë korresponduese të ditës së muajit kalendari në të cilën fillon afati, atëherë afati do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendari të periudhës.

2.1.7 Nënshkrim elektronik do të thotë vendosja e kodit të verifikimit që kredimarrësi merr me sms në numrin e telefonit i cili do të shërbejë si nënshkrim autentik i Kredimarrësit. Nëpërmjet vendosjes së këtij kodit verifikimi Kredimarrësi gjithashtu deklaron se është në dijeni të plotë dhe pranon parashikimet e Tabelës së Interesit dhe Tarifave, Kushteve të Llogarisë Online dhe të Politikës së Privatësisë të Kredidhënësit.

2.1.8 Termat e përcaktuar në njëjës përfshijnë edhe shumësin, dhe anasjelltas.

3. Objekti dhe Qëllimi i Përdorimit të kredisë

3.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, dhe sipas kushteve të saj, Kredidhënësi pranon t'i japë kredi me këste Kredimarrësit, duke i miratuar një linjë kredie për përdorim blerje mallrash qarkullues deri në vlerën e Limitit, dhe Kredimarrësi pranon të marrë Kredi me këste nga Kredidhënësi, herë pas here, dhe të kthejë shumat e marra kredi, si dhe të paguajë Interesin dhe Tarifat sipas kushteve të rëna dakord në këtë Kontratë.

4. Afati

4.1 Kjo Kontratë lidhet dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar, duke nisur nga Data e Lidhjes (“Afati”), përveçse kur kjo Kontratë zgjidhet sipas parashikimeve të Nenit 13 të kësaj Kontrate.

4.2 Me marrjen e Njoftimit mbi tërheqjen e Kredimarrësit, Kredidhënësi, nëpërmjet një Njoftimi me shkrim, do të informojë Kredimarrësin mbi shumat që duhen kthyer nga Kredimarrësi (nëse ka), të cilat do të përfshijnë çdo shumë të disbursuar, Interesin e zbatuar gjatë ditëve përkatëse si dhe çdo kosto tjetër e shpenzimit të mundshme që Kredidhënësi ka hasur nga veprime me palë të treta, për efekt të miratimit dhe disbursimit të Kredisë (këto shuma do të përbëjnë pjesë të Shumave të Pashlyera të kësaj Kontrate).

4.3 Nëse Kredimarrësi nuk i paguan Kredidhënësit shumat si më sipër, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga data e Data e Lidhjes së kësaj Kontrate, atëherë tërheqja e Kredimarrësit nga Marrëveshja nuk do të çenojë zbatueshmërinë e parashikimeve sipas Neneve 8, 9, 12, 14, 16, 17 dhe 18 të kësaj Kontrate, të cilat do t'i mbijetojnë tërheqjes së Kredimarrësit.

5. Limiti

5.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredidhënësi i ka miratuar Kredimarrësit Limitin për të cilin është njoftuar rregullisht Kredimarrësi.

5.2 Kredidhënësi, me diskrecionin e tij të vetëm, ka të drejtë të ulë Limitin me efekt të menjëhershëm, nëse Kredimarrësi shkel detyrimet sipas kësaj Kontrate, apo rrezikon një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi. Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit çdo vendim për ulje të Limitit.

5.3 Kredimarrësi ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë një Aplikim për Limit, duke kërkuar rritjen e Limitit të miratuar më parë nga Kredidhënësi. Në rast të një Aplikimi për Limit, Kredidhënësi ka të drejtë t'i kërkojë Kredimarrësit çdo informacion apo dokument që vlerëson të nevojshëm për analizën e kërkesës, me kusht që miratimi i çdo rritjeje të Limitit do të jetë në diskrecion të vetëm të Kredidhënësit.

5.4 Pavarësisht ndonjë Aplikimi për Limit, Kredidhënësi, në diskrecion të vetëm, mund të rrisë Limitin e miratuar më parë, nëse Kredimarrësi ka një historik të mirë kreditimi me Kredidhënësin. Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit çdo vendim për rritje të Limitit.

6. Disbursimet dhe Kthimi i Kredisë

6.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Kredimarrësi ka të drejtë, herë pas here, me zgjedhjen e tij/saj të vetme, të paraqesë Aplikime Disbursimi, duke kërkuar lëvrimin e çdo shume, deri në vlerën e Limitit dhe çdo shumë e Disbursuar nga Kredidhënësi do të përbëjë një Shumë Kredie.

6.2 Për çdo Aplikim Disbursimi paraqitur sipas kësaj Kontrate, Kredimarrësi detyrohet të paguajë Tarifen përkatëse sipas Tabelës së Interesit dhe Tarifave në fuqi në momentin e aplikimit.

6.3 Kredidhënësi rezervon të drejtën për të mos kryer Disbursimin, nëse Kredimarrësi njofton zgjidhjen e Kontratës, shkel detyrimet sipas kësaj Kontrate apo rrezikon një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, ose gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi. Kredidhënësi gjithashtu rezervon të drejtën për të mos kryer Disbursimin, nëse Kredimarrësi nuk ka pranuar versionin në fuqi të Tabelës së Interesit dhe Tarifave.

6.4 Disbursimi do të kryhet në para në dorë pranë Degëve, apo nëpërmjet një transference në Llogarinë Bankare të Kredimarrësit.

6.5 Kredimarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga marrëveshja dhe/ose Marrëveshja e kredisë, pa dhënë ndonjë arsye për këtë qëllim, brenda një periudhe kalendarike 14 (katërmëdhjetë) ditore. Ky afat fillon nga dita e disbursimit dhe njoftimi për tërheqjen duhet të kryhet me shkrim tek Kredidhënësi.

6.6 Kredidhënësi njofton Kredimarrësin në rastin e kërkesës me shkrim për tërheqje nga Marrëveshja, për vlerën e kredisë, që duhet t'i rikthehet nga Kredimarrësi dhe interesit dhe tarifave të tjera për ditët përkatëse, si dhe shpenzimet e mundshme të Kredidhënësit të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj Kredie.

6.7 Në vijim të një Disbursimi, Kredimarrësi do të kthejë Shumën e Kredisë në Datat e Pagesave përcaktuar në Grafikon e Pagesave. 6.8 Kredimarrësi ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë një Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, duke kërkuar ndryshimin e kësteve dhe Datës së Pagesave në lidhje me një Disbursim të mëparshëm.

6.9 Për çdo Aplikim për Ndryshimin e Kushteve paraqitur sipas kësaj Kontrate, Kredimarrësi detyrohet të paguajë Tarifën përkatëse përcaktuar sipas Tabelës së Interesit dhe Tarifave në fuqi në momentin e aplikimit. Kredidhënësi rezervon të drejtën për të mos miratuar një Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, nëse Kredimarrësi nuk ka pranuar versionin në fuqi të Tabelës së Interesit dhe Tarifave.

6.10 Kredidhënësi ka të drejtë t'i kërkojë Kredimarrësit çdo informacion apo dokument të vlerësuar të nevojshëm për analizën e Aplikimit për Ndryshimin e Kushteve dhe miratimi i çdo Aplikimi për Ndryshimin e Kushteve do të jetë në diskrecion të vetëm të Kredidhënësit. 6.11 Çdo Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, i cili është miratuar nga Kredimarrësi, do të zëvendësojë Grafikon e Pagesave për Disbursimin e kryer më parë. 6.12 Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit miratimin e çdo Aplikimi Disbursimi dhe/ose Aplikimi për Ndryshimin e Kushteve.

7. Interesi dhe Tarifat

7.1 Norma nominale e interesit për shlyerjen e kredisë do të jetë e pandryshueshme në vit, llogaritur mbi kryegjënë e mbetur ashtu sic përcaktohet në Tabelën e Interesit dhe Tarifave. 7.2 Norma Efektive e Interesit është totali i kostos së kredisë për kredimarrësin dhe formula e përlllogaritjes shprehet në Aneksin 1 të kësaj Kontrate. Norma Efektive e Interesit për këtë linjë kredie përlllogaritet për Vlerën e Limitit të Aprovuar, tarifat maksimale të aplikuara gjatë jetës së kredisë kur linja e aprovuar merret njëherësh apo në disa pjesë nga klienti, dhe këste të barabarta mujore për 12 muaj. Kredimarrësi do t'i paguajë Kredidhënësit Interesin mbi Shumat e Kredisë që rezultojnë të pakthyera, sipas Normës së Interesit të përcaktuar në Tabelën e Interesit dhe Tarifave, në fuqi në momentin e Aplikimit për Disbursim, apo të Aplikimit për Ndryshim të Kushteve. Interesi do të llogaritet sipas mënyrave të parashikuara në Tabelën e Interesit dhe Tarifave. Shembull 1: Supozojmë se klienti tërheq një kredi me vlerë 200,000 ALL, me maturitet 12 muaj, me Normë Nominale Interesi 13.80 % në vit, komision angazhimi mujor 17 %. Në këtë mënyrë, klienti do të paguajë për 12 muaj një kësht mujor prej 20,770 ALL, Pra, në total, gjatë 12 muajve, klienti do të paguajë 249,200 ALL. Norma efektive e interesit (NEI) për këtë kredi rezulton 52.4 %. 7.3 Interesi do të paguhet nga Kredimarrësi në Datat e Pagesave, siç parashikohet nga Grafiku i Pagesave. 7.4 Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë gjithashtu Kredidhënësit Tarifatat sipas Tabelës së Interesit dhe Tarifave, në fuqi në momentin kur zbatohet Tarifa dhe përveçse kur parashikohet ndryshe, çdo Tarifë duhet të paguhet nga Kredimarrësi përpara çdo aplikimi që mund t'i paraqitet Kredidhënësit.

8. Tarifë mbi Vonesat

8.1 Nëse Kredimarrësi nuk kthen Shumat e Kredisë, apo nuk paguan Interesin, dhe/ose Tarifatat e papaguara, ("Shumat e Pashlyera") sipas afateve të parashikuara në këtë Kontratë, atëherë Kredidhënësi ka të drejtë të zbatojë Kamatëvonesën e përcaktuar dhe llogaritur sipas Tabelës së Interesit dhe Tarifave, në fuqi në momentin e zbatimit. Shembull: Supozojmë se për një kësht pagese kemi 1,000 ALL Principal + 50 ALL Interes + 10 ALL Komision. Në rast se ky kësht nuk paguhet në datën e përcaktuar në grafikon e pagesave, dhe pagesa rezulton me një ditë vonesë, kamata e vonesës përlllogaritet: $(1,000 + 50 + 10) * 2\% = 21.2$ ALL. Në ditën e dytë, kjo kamatëvonesë do të jetë $21.2 * 2 = 42.4$ ALL, dhe me rritjen e ditëve të vonesës, kamatëvonesa rritet për çdo ditë vonesë me vlerën 21.2 ALL, deri kur arrijn maksimumin e saj të lejuar, që është i njëjtë me vlerën e kredisë së marrë. 8.2 Zbatimi i Kamatëvonesës sipas parashikimeve të mësipërme nuk çënon të drejtën e Kredidhënësit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm sipas Nenit 17, pa qenë i detyruar të zgjidhë Kontratën, dhe/ose të zgjidhë Kontratën sipas Nenit 13.

9. Kryerja e Pagesave

9.1 Çdo pagesë që Kredimarrësi detyrohet të kryejë ndaj Kredidhënësit sipas kësaj Kontrate, do të kryhet me para në dorë pranë Degëve, me transfertë pranë Llogarive Bankare të Kredidhënësit, apo pranë partnerëve të autorizuar rregullisht nga Kredidhënësi, të cilët janë të renditur tek Faqja e Internetit, në monedhën e parashikuar për Shumën e Kredisë, Interesin dhe Tarifatat. Çdo pagesë që Kredimarrësi detyrohet të kryejë ndaj Kredidhënësit, do të konsiderohet e arkëtuar nga Kredidhënësi në momentin që fondet depozitohen pranë Degëve ose pranë partnerëve të autorizuar, apo kreditohen në Llogaritë Bankare të Kredidhënësit.

9.2 Kredimarrësi detyrohet të kryejë çdo pagesë ndaj Kredidhënësit sipas kësaj Kontrate, në shumë të plotë, pa kryer asnjë ulje, mbajtje apo kompensim dhe çdo kosto bankare që mund të lidhet me kryerjen e Disbursimeve, apo me pagesën e ndonjë shume që Kredimarrësi paguan sipas kësaj Kontrate, do të përballohet nga Kredimarrësi.

9.3 Kredimarrësi pranon se Kredidhënësi mund të mbajë, zbrësë apo kompensojë nga shuma e çdo Disbursimi/pagese, çdo shumë që Kredimarrësi i detyrohet Kredidhënësit sipas kësaj Kontrate. Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohe edhe para afatit të maturimit shlyerje të pjesshme të detyrimeve të tij të lindura nga Marrëveshja e kredisë, duke njoftuar me shkrim. Në këtë rast Kredidhënësi do të bëjë reduktim të koston totale të kredisë, duke ulur shumën e interesit dhe shpenzime të tjera të aplikueshme për shumën e kryegjësë së shlyer para afatit të maturimit. 9.4 Në rast të pagimit të plotë të detyrimeve përpara kohe, Kredidhënësi do të reduktojë koston totale të kredisë sipas kushteve rregullatore, por duke rezervuar të drejtën për të zbatuar tarifën e parapagimit, sipas Tabelës së Interesit dhe Tarifave, në fuqi në momentin e parapagimit (3 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit; dhe 5% të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit). Në çfarëdo rast parapagimi, siç përmendet këtu, Kredimarrësi duhet t'i dërgojë Kredidhënësit një Njoftim paraprak duke e informuar mbi parapagimin në fjalë dhe duke i kërkuar rilllogaritjen e Grafikut të Pagesave dhe koston totale të kredisë së përmendur këtu.

9.5 Të gjitha pagesat e marra nga Kredidhënësi dhe të kryera nga Kredimarrësit sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate do të llogariten si vijon:

Në radhë të parë, për shlyerjen e shpenzimeve të kryera për mbledhjen e kredisë në vonesë;

Në radhë të dytë, për shlyerjen e tarifës së vonesës;

Në radhë të tretë, për shlyerjen e të gjithë Tarifave

Në radhë të katërt, për shlyerjen e Interesit;

Në radhë të pestë, për shlyerjen e Kryegjësë;

9.6 Në rast se pagesat që duhen kryer në favor të Kredidhënësit do të bëhen nga një palë e tretë e autorizuar nga Kredimarrësi, Kredimarrësi duhet të njoftojë rregullisht Kredidhënësin më parë se pala e tretë të kryejë pagesat që duhen bërë ndaj Kredidhënësit, nëpërmjet dërgimit të Njoftimit mbi sa përmendet këtu, duke dhënë informacion mbi palën e tretë, siç do të kërkohej nga Kredidhënësi. Kredidhënësi nuk ka detyrim të pranojë pagesat e kryera nga palë të treta të paidentifikuara të bëra për llogari të Kredimarrësit nëse Kredimarrësi nuk informon siç duhet Kredidhënësin mbi sa më lart.

10. Llogaria Online

10.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi hap dhe mban një llogari elektronike të kredimarrësit ("Llogaria Online") pranë Kredidhënësit, sipas kushteve dhe afateve të Llogarisë Online ("Kushtet e Llogarisë Online").

10.2 Llogaria Online do të jetë e aksesueshme elektronikisht nga Faqja e Internetit, sipas parashikimeve të Kushteve të Llogarisë Online.

10.3 Llogaria Online do të shërbejë si një platformë nëpërmjet së cilës Kredimarrësi do të menaxhojë marrëdhënien e tij me Kredidhënësin sipas kësaj Kontrate, çka përfshin, marrjen e informacionit mbi gjendjen e detyrimeve apo mbi transaksionet e kryera, kryerjen e ndryshimeve në të dhënat e Kredimarrësit, marrjen apo kryerjen e Njoftimeve për/nga Kredidhënësi, kryerjen e aplikimeve të ndryshme, etj. Llogaria Online nuk do të ketë funksionin e një sistemi pagese, për sa kohë që nuk përmbush kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

10.4 Të dhënat e Llogarisë Online do të trajtohen nga Kredidhënësi në përputhje me kushtet e zbatueshme të Politikës së Privatësisë.

11. Deklarimet dhe Garancitë e Kredimarrësit

11.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi garanton dhe i deklaron Kredidhënësit, se:

11.1.1 Të gjitha informacionet / dokumentat e paraqitura nga Kredimarrësi për miratimin e aplikimit fillestar të Kredisë, dhe/ose ato që mund t'i paraqiten herë pas here gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi, janë / do të jenë të vërteta e të plota në çdo aspekt, në datën e paraqitjes së tyre tek Kredidhënësi.

11.1.2 Kredimarrësi ka marrë të gjithë informacionin dhe sqarimet e nevojshme para-kontraktore, në lidhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate.

11.1.3 Kjo Kontratë është lidhur lirisht mes Kredimarrësit dhe Kredidhënësit dhe përmban detyrime të vlefshme dhe të zbatueshme ndaj Kredimarrësit dhe personave të tjerë që, sipas ligjit, heqin të drejta prej tij.

11.1.4 Në Datën e Lidhjes, Kredimarrësi nuk gjendet nën ndonjë procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm apo falimentimi dhe se këto procedura nuk kanë gjasa të ndodhin dhe se Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi ndonjë rrethanë që mund të çojë në nisjen ndaj Kredimarrësit, të ndonjë procedure të ekzekutimit të detyrueshëm apo falimentimi.

11.1.5 Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi ndonjë rrethanë që mund të krijojë ndonjë rrezik për një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi.

11.1.6 Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi çdo ndryshim të të dhënave të Kredimarrësit, deklaruar në hyrje të kësaj Kontrate.

12. Gjuha dhe Njoftimet

12.1 Kjo Kontratë lidhet në gjuhën Shqipe dhe çdo njoftim, kërkesë ose komunikim apo dokument tjetër që dërgohet në lidhje me këtë Kontratë ("Njoftimi") do të jetë në formë të shkruar dhe në gjuhën Shqipe.

12.2 Kredidhënësi mund të kryejë Njoftime në adresën fizike, në adresën e-mail apo në kontaktet e tjera të deklaruara nga Kredimarrësi më sipër në këtë Kontratë, apo në ndonjë adresë apo kontakt tjetër të Njoftuar nga Kredimarrësi herë pas here. Kredidhënësi mund të kryejë gjithashtu Njoftime për Kredimarrësin nëpërmjet mesazheve elektronike në Llogarinë Online.

12.3 Çdo Njoftim i kryer nga Kredidhënësi do të konsiderohet i kryer rregullisht ndaj Kredimarrësit, menjëherë: (a) pasi njoftimi kryhet dorazi tek Kredimarrësi; (b) pas dërgimit të mesazhit në adresën e-mail të Kredimarrësit; (c) me aksesimin e Llogarisë Online nga Kredimarrësi.

12.4 Çdo Njoftim i kryer nga Palët me shërbim postar, në adresën fizike të Palës tjetër, konsiderohet i kryer rregullisht ndaj marrësit, në ditën e dytë, pas datës së dorëzimit të Njoftimit tek shërbimi postar, pavarësisht momentit të marrjes nga marrësi.

12.5 Pavarësisht sa më sipër, çdo Njoftim i kryer me mjete të tjera komunikimi, i cili provohet të jetë kryer/marrë efektivisht, nuk do të konsiderohet i pavlefshëm vetëm për faktin se njoftimi apo komunikimi është dërguar/marrë në mënyra të ndryshme nga sa më sipër.

13. Zgjidhja e Kontratës dhe Pasoja e Zgjidhjes

13.1 Nëse Kredimarrësi shkel detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, kjo shkelje do të përbëjë një "Rast Mospërmbylljeje" të kësaj Kontrate.

13.2 Nëse ka një Rast Mospërmbylljeje, Kredidhënësi mund t'i kërkojë Kredimarrësit me shkrim të korrigjojë Rastin e Mospërmbylljes ("Njoftimi i Korrigjimit"), brenda një afati të arsyeshëm (por jo më të shkurtër se 15 ditë), dhe mund të zgjidhë këtë Kontratë, nëpërmjet një njoftimi të shkruar drejtuar Kredimarrësit ("Njoftimi i Zgjidhjes"), nëse:

13.3 Rasti i Mospërmbylljes nuk korrigjohet brenda këtij afati; ose,

13.3.1 kur Rasti i Mospërmbylljes është i pamundur të korrigjohet, Palët nuk merren vesh brenda këtij afati për një kompensim të arsyeshëm.

13.4 Njoftimi i Zgjidhjes dërguar nga Kredidhënësi do të ketë si pasojë zgjidhjen e kësaj Kontrate, me efekt nga data e Njoftimit të Zgjidhjes, apo nga data e mëvonshme shënuar në Njoftimin e Zgjidhjes.

13.5 Palët bien dakord shprehimisht se Kredidhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, pa ndjekur procedurën e mësipërme, nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje drejtuar Kredimarrësit, në rastet vijuese, të cilat Palët bien dakord se janë me interes thelbësor për Kredidhënësin:

13.5.1 Kredimarrësi nuk paguan Shumat e Pashlyera, sipas afateve të kësaj Kontrate; ose

13.5.2 Kredimarrësi është në shkelje të deklarimeve dhe garancive sipas Nenit 11 të kësaj Kontrate; ose

13.5.3 Kredimarrësi ka pësuar një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi;

13.5.4 Kredimarrësi nuk pranon ndryshimet e Njoftuara nga Kredidhënësi në Kushtet e Llogarisë Online si dhe në Politikën e Privatësisë;

13.5.5 Nëse Kredidhënësi nuk mund t'ja japë më Kreditin Kredimarrësit, në rast se Llogaria bankare e Kredimarrësit është bllokuar apo mbyllur, dhe nuk mund të kryhet transferimi i fondeve, me kusht që Kredimarrësi të mos ketë hapur dot një llogari të re bankare e të mos ketë njoftuar rregullisht Kredidhënësin nëpërmjet Njoftimit;

13.5.6 Nëse Kredidhënësi ka identifikuar se Kredimarrësi është bërë një person i ekspozuar politikisht;

13.5.7 Nëse Kredidhënësi është deklaruar i paafte për të vepruar me zotësi të plotë ligjore dhe biznesi.

13.6 Kredimarrësi mund të zgjidhë këtë Kontratë nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje të shkruar drejtuar Kredidhënësit, në rast të zvogëlimit të Limitit sipas Nenit 5.2, të një refuzimi disbursimi sipas Nenit 6.3, apo gjatë periudhës së përcaktuar sipas Nenit 15.3 të kësaj Kontrate, nëse Kredimarrësi vendos të mos pranojë ndryshimin e Njoftuar nga Kredidhënësi sipas Nenit 15.3 të kësaj Kontrate.

13.7 Secila Palë mund të zgjidhë këtë Kontratë nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje të shkruar drejtuar Palës tjetër, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, pa qenë i nevojshëm përcaktimi i shkakut të zgjidhjes.

13.8 Kredimarrësi nuk mund të zgjidhë këtë Kontratë, përveçse në rastet e parashikuara më sipër sipas këtij Neni.

13.9 Në çdo rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate, afati i pagesës së Shumave të Pashlyera që Kredimarrësi i detyrohet Kredidhënësit do të përshpejtohet, duke u bërë të detyrueshme për t'u paguar nga Kredimarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të zgjidhjes, pavarësisht afateve të rena dakord më parë.

13.10 Zgjidhja e kësaj Kontrate nuk do të çenojë zbatueshmërinë e parashikimeve sipas Neneve 8, 9, 12, 14, 16, 17 dhe 18 të kësaj Kontrate, të cilat do t'i mbijetojnë zgjidhjes së kësaj Kontrate.

14. Ligji i Zbatueshëm dhe Gjykatat Kompetente

14.1 Kjo Kontratë do të rregullohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

14.2 Secila Palë bie dakord dhe pranon në mënyrë të përvokueshme se çdo mosmarrëveshje, padi, masë sigurimi, urdhër ekzekutimi apo procedurë tjetër gjyqësore, që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë, ("Mosmarrëveshja") do të zgjidhet në mënyrë ekskluzive nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14.3 Palët bien gjithashtu dakord se nisja apo vazhdimi i një Mosmarrëveshjeje nuk do të përbëjë një shkak të vlefshëm për ndërprerjen e zbatimit të kësaj Kontrate dhe nuk do të çlirojë Kredimarrësin nga vazhdimi i përbushjes së detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet kësaj Kontrate.

15. E Gjithë Marrëveshja, Ndryshimet

15.1 Kjo Kontratë, përfshirë deklaratat hyrëse dhe dokumentat bashkëlidhur, përfaqëson kontratën përfundimtare dhe të plotë të Palëve në lidhje me objektin e saj dhe shfuqizon e zëvendëson çdo Kontratë, marrëveshje paraprake apo diskutime të mëparshme, qofshin këto verbale ose me shkrim, ndërmjet po këtyre Palëve në lidhje me të njëjtin objekt.

15.2 Dispozitat e kësaj Kontrate nuk mund të ndryshohen përveçse me anë të një marrëveshjeje të shkruar (e cila mund të përfshijë dhe marrëveshje në formë elektronike) lidhur rregullisht nga Palët, dhe çdo ndryshim i tillë do të prodhojë efekte duke filluar nga data e nënshkrimit nga Palët (përveçse kur data e hyrjes në fuqi është parashikuar ndryshe).

15.3 Pa çenuar parashikimet e mësipërme, Palët bien dakord se Kredidhënsi, nëpërmjet një Njoftimi drejtuar Kredimarrësit, ka të drejtë të ndryshojë Interesin dhe Tarifave të zbatueshëm ndaj një shume të Disbursuar më parë, nëse në vijim të Disbursimit, ndryshohet Tabela e Interesit dhe e Tarifave. Në këto raste, ndryshimi i Njoftuar nga Kredidhënsi nuk do të ketë efekt ndaj Kredimarrësit përpara skadimit të një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e Njoftimit të Kredimarrësit. Kredimarrësi ka të drejtë t'i Njoftojë Kredidhënsit zgjidhjen e Kontratës, sipas Nenit 13.5 të kësaj Kontrate.

15.4 Nëse Kredimarrësi nuk i paraqet Kredidhënsit një Njoftim Zgjidhjeje, sipas Nenit 13.5 të kësaj Kontrate, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor të cituar më sipër, atëherë ndryshimi i Interesit dhe Tarifave të Njoftuar nga Kredidhënsi, do të fillojë të zbatohet duke nisur nga përfundimi i këtij afati.

15.5 Duke nënshkruar këtë kontratë, Klienti deklaron se është vënë në dijeni, i kupton dhe bie dakord me faktin që duhet të njihet në mënyrë të vazhdueshme me Tabelën e Interesit dhe Tarifave të publikuar në ambientet e Kredidhënsit dhe në faqen e tij në internet për t'u njohur mbi ndryshimet e mundshme të termave dhe kushteve të kësaj kontrate apo elementeve të tjera që mund të kenë impakt mbi këtë kontratë.

16. Kalimi

16.1 Të drejtat dhe detyrimet e Kredimarrësit sipas kësaj Kontrate nuk mund t'i kalohen një personi të tretë, pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Kredidhënsit për pranimin e këtij personi të tretë si debitor i ri, dhe ky pëlqim do të jetë në diskrecionin e vetëm të Kredidhënsit, përveç rasteve kur detyrimi i Kredimarrësit i kalohet personave të tretë sipas rregullave të trashëgimisë ligjore.

16.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi i jep që tani pëlqimin e tij të përvokueshëm Kredidhënsit, për t'i kaluar të drejtat dhe/ose detyrimet ndaj Kredidhënsit sipas kësaj Kontrate një personi të tretë.

16.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Kredimarrësi jep gjithashtu, pëlqimin e tij të përvokueshëm, që Kredidhënsi të japë apo kalojë, plotësisht apo pjesërisht, në çdo formë, të drejta pagese mbi shumat e arkëtueshme sipas kësaj Kontrate, në favor të çdo pale të tretë, pa njoftuar Kredimarrësin, dhe Kredimarrësi, për as kohë nuk ka marrë njoftim mbi ndonjë kalim sipas këtij neni, mbetet i detyruar të kryejë pagesat sipas kësaj Kontrate, drejtpërdrejt ndaj Kredidhënsit.

17. Titulli Ekzekutiv

17.1 Kjo Kontratë përbën një akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jo-bankare dhe si e tillë është titull ekzekutiv i detyrueshëm për Kredimarrësin.

17.2 Nëse Kredimarrësi nuk paguan Shumat e Pashlyera, sipas kushteve dhe brenda afateve të përcaktuara sipas kësaj Kontrate, atëherë Kredidhënsi i lind e drejta të nisë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për Kredimarrësin, pa çenuar të drejtën e Kredidhënsit për të marrë masat e tjera në dispozicion të tij sipas kësaj Kontrate dhe/ose sipas ligjit.

18. Të Ndryshme

18.1 Kredidhënsi nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë që i njihet sipas kësaj Kontrate, apo sipas ligjit, dhe Kredimarrësi nuk do të konsiderohet i çliaruar nga detyrimi për të përbushur plotësisht këtë Kontratë, përveçse kur një dorëheqje e tillë është bërë shprehimisht me shkrim nga Kredidhënsi.

18.2 Çdo vonesë nga ana e Kredidhënsit në ushtrimin e ndonjë të drejte që i njihet sipas kësaj Kontrate, apo sipas ligjit, nuk do të pengojë ushtrimin e mëvonshëm të kësaj të drejte, apo ndjekjen e masave ligjore, për sa kohë këto të drejta nuk janë parashikuar sipas ligjit.

18.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate konstatohet apo deklarohet nga gjykata kompetente si e pavlefshme apo e pazbatueshme, atëherë kjo nuk do të prekë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të Kontratës, dhe dispozita e prekur do të quhet e zëvendësuar automatikisht me një dispozitë të vlefshme, e cila ndjek, për sa është e mundur, qëllimin origjinal të Palëve. Zëvendësimi automatik i dispozitës sipas këtij parashikimi do të jetë pasoja e vetme mes Palëve, nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate konstatohet apo deklarohet si e pavlefshme apo e pazbatueshme.

NË PRANI TË NJËRA TJETRËS, Palët lidhin këtë Kontratë në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilën Palë, në datën e shënuar më sipër.

Për Kredidhënsin:

Kredimarrësi:

[Emër, Mbiemër, Firmë]
Përfaqësues i Autorizuar

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Në bazë të Nenit 686 të Kodit Civil, Kredimarrësi deklaron se është në dijeni të plotë të parashikimeve sipas Neneve 5.2, 6.3, 8, 9, 13, 14, 15.3, 16 dhe 17 të kësaj Kontrate, dhe i miraton ato veçmas nëpërmjet këtij nënshkrimi. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate, Kredimarrësi, gjithashtu deklaron se është në dijeni të plotë dhe pranon parashikimet e Tabelës së Interesit dhe Tarifave, Kushteve të Llogarisë Online dhe të Politikës së Privatësisë të Kredidhënsit, siç janë në fuqi në Datën e Lidhjes. Çdo ndryshim i këtyre dokumenteve do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, sipas kësaj Kontrate dhe do të hyjë në fuqi të paktën 15 ditë mbas nënshkrimit.

Kredimarrësi:

ANEKS 1

Formula e perlllogaritjes se Normes Efektive te Interesit (NEI) paraqitet si me poshte:

$$\sum_{K=1}^{K=m} \frac{A_K}{(1+i)^{t_K}} = \sum_{K_2=1}^{K_2=m_2} \frac{A_{2K}}{(1+i)^{t_{K_2}}}$$

, ku

K – Numri që identifikon një dhënie kredie të caktuar

K_2 – Numri që identifikon një kësht të caktuar

A_K – Vlera e nje K-je

A_{K_2} – Vlera për një kësht K

Σ – Përfaqëson totalin e disa elementëve të caktuar

m – Numri I dhënieve të kredisë

m_2 – Numri total I kësteve

t_K – Interval I shprehur në vite ndërmjet datës së caktuar dhe datës së lëvrimit të rradhës dhe të atyre që vijnë më pas 3 deri në m

t_{K_2} – Interval I shprehur në vite ndërmjet datës së caktuar dhe datës së pagesës së kësteve nga 1 në m_2